

Letërnjoftimi i Komunës së

MITROVICËS

2014

Maj, 2015




Fakte

- Krijimi i Komunës së Mitrovicës së Veriut ia ka zvogëluar buxhetin Mitrovicës së Jugut për rreth 1.5 milionë euro.
- Komuna e Mitrovicës gjatë vitit 2014 ka rritur të hyrat vetanake për rreth 300,000 euro.
- Komuna e Mitrovicës është e nënta në nivel të komunave të vendi për nga shkalla e të hyrave vetanake, qëndron pas Prishtinës, Gjakovës, Pejës, Ferizajt, Prizrenit, Fushë Kosovës, Vushtrrisë dhe Lipjanit. Mitrovica për nga të hyrat vetanake është e përafërt me Suharekën.
- Komuna e Mitrovicës gjatë vitit 2014 ka trashëguar borxh nga mandati i kaluar në vlerë prej 1.1 milionë euro. Pjesa më e madhe e këtij borxhi është paguar.
- Komuna e Mitrovicës ka gjithsejtë 1,881 persona të punësuar, ku përfshihen 301 në Administratë dhe të tjerët janë në sistemin shëndetësor dhe atë arsimor.
- Gjatë një viti në Mitrovicë hapen mesatarisht deri në 400 biznese të reja. Mitrovica llogaritet në mesin e komunave të mëdha të vendit, por krahasuar me komunat e tjera (Peja, Prizreni, Gjakova, Gjilani) Mitrovica karakterizohet me numër dukshëm më të vogël të bizneseve që hapen gjatë një viti.
- Kryetari i Komunës Agim Bahtiri gjatë fushatës zgjedhore ka dhënë 17 premtime, deri në maj të 2015 rezultojnë të përmbushura 29% e tyre.

2 Qeverisja komunale


Komuna e Mitrovicës në zgjedhjet e fundit lokale (nëntor 2013) ka kaluar nga qeverisja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Aleancën Kosova e Re (AKR). Ish kryetari i Mitrovicës Avni Kastrati (PDK) ka humbur garën në balotazh me kandidatin e AKR-së Agim Bahtiri. Në raundin e parë të zgjedhjeve Kastrati ka fituar 43% të votave, kundrejt Bahtirit i cili në raundin e parë ka siguruar 22% të votave. Në balotazh Bahtiri ka arritur të marrë 53%, ndërsa Kastrati 47%.

Grafikoni nr.1 Numri i votave në raundin e parë dhe në balotazh në zgjedhjet lokale 2013 në Mitrovicë



Pas zgjedhjeve kreu i komunës ka hyrë në koalicion me Lidhjen Demokratike të Kosovës dhe me Aleancën për Ardhmerinë e Kosovës.


Grafikoni nr. 2 Ndarja e ulëseve sipas partive në Kuvendin Komunal të Mitrovicës sipas zgjedhjeve të 2013



3 Buxheti i Komunës së Mitrovicës


Komuna e Mitrovicës gjatë vitit 2014 ka pasur në dispozicion buxhet mbi 15 milionë euro. Vlerësuar nga vitet paraprake kjo komunë ka rënie të buxhetit. Kjo ka ardhur pas implikimeve që ka pasur themelimi i Komunës së Mitrovicës së Veriut dhe ndarja e granteve nga niveli qendror, pas të dhënave të regjistrimit të popullsisë.

Grafikoni nr.3 Buxheti total i Komunës së Mitrovicës dhe ndarjes sipas kategorive




Të hyrat vetanake të Komunës së Mitrovicës gjatë 2014 kanë shënuar ngritje në krahasim me një vit paraprak. Shuma e ngritjes se të hyrave ka qenë rreth 300,000 euro, ndërsa të hyra në total Mitrovica gjatë 2014 ka realizuar rreth 1.7 milionë euro.

Grafikoni nr.4 Të hyrat vetanake të Mitrovicës nga vitit 2011-2014




Komuna e Mitrovicës gjatë vitit 2014 ka trashëguar borxh nga mandati i kaluar në vlerë prej 1.1 milionë euro. Pjesa më e madhe e këtij borxhi është paguar, përveç rasteve kur është dashur të pritët edhe vendimet e gjykatave të adresuara nga operatorët ekonomik të cilët kanë qenë të pakënaqura me vlerësimin e kostos së punëve të kryera. Mjetet për të paguar borxhet e mbetura të 2013 janë marr kryesisht nga të hyrat vetanake, fakt ky që ka zvogëluar projektet e realizuara në investime kapitale më 2014.

Grafikoni nr.5 Kategoritë e të hyrave buxhetore në Mitrovicës për vitin 2014



Komuna e Mitrovicës është e nënta në nivel të komunave të vendi për nga shkalla e të hyrave vetanake, qëndron pas Prishtinës, Gjakovës, Pejës, Ferizajt, Prizrenit, Fushë Kosovës, Vushtrrisë dhe Lipjanit. Mitrovica për nga të hyrat vetanake është e përafërt me Suharekën.


Grafikoni nr.6 Krahasimi i komunave nga vështrimi i të hyrave vetanake për vitin 2014



4 Të punësuarit në sektorin publik

Komuna e Mitrovicës ka gjithsejtë 1,881 persona të punësuar, ku përfshihen 301 në Administratë dhe të tjerët janë në sistemin shëndetësor dhe arsimor.


Grafikoni nr.7 Të punësuarit në sektorin publik në Komunën e Mitrovicës



Mitrovica ka numër të madh të punësuarëve në administratë nëse krahasohet numri i të punësuarve me numrin e banorëve. Mesatarja në shkallë vendi është një shërbyes civil për 278 banorë.

Grafikoni nr.8 Raporti i të punësuarëve në administratë për kokë banori


Të punësuar për kokë banori



Në sektorin e arsimit janë të punësuar 1,294 persona, prej tyre 1,004 janë mësimdhënës. Në Komunën e Mitrovicës raporti nxënës/mësimdhënës është 35. Mesatarja në shkallë vendi është 29.9.

Grafikoni nr.10 Raporti nxënës-mësimdhënës sipas komunave


Raporti Nxënës/Mësimdhënës



Në sektorin e shëndetësisë janë të punësuar 286 persona. Raporti punonjës shëndetësorë/popullatë në Komunën e Mitrovicës është 356.5. Mesatarja në shkallë vendi është 282.7.

Grafikoni nr.11 Raporti nxënës-mësimdhënes sipas komunave


Punonjës shëndetësor për kokë banori



5 Ekonomia lokale

Gjatë një viti në Mitrovicë hapen mesatarisht deri në 400 biznese të reja. Mitrovica llogaritet në mesin e komunave të mëdha të vendit, por krahasur me komunat e tjera (Peja, Prizreni, Gjakova, Gjilani) Mitrovica karakterizohet me numër dukshëm më të vogël të bizneseve që hapen gjatë një viti.


Grafikoni nr.12 Trendi i hapjes së bizneseve në Komunën e Mitrovicës 2011-2014 sipas llojit



Instituti GAP

Në të njëjtën periudhë (2014) në Mitrovicë janë shuar 97 biznese, pjesa më e madhe e tyre i takojnë profilit të bizneseve tregtare.

Grafikoni nr.13 Shuarja e bizneseve në Mitrovicë në total dhe sipas llojit 2011-2014



6 Premtimet

Instituti GAP ka monitoruar premtimet e dhëna nga z. Agim Bahtiri gjatë fushatës zgjedhore 2013. Nga 17 premtimet e monitoruara, deri në maj 2015 z.Bahtiri ka arritur të realizoj 29% të premtimeve. Mesatarja e premtimeve të realizuara për të gjitha komunat e Kosovës deri në maj 2015 është 24%.

Grafikoni nr.14 Numri i premtimeve dhe shkalla e realizimit

